

VENDIM
Nr.27, datë 15.12.2008

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Gjergj Sauli	Anëtar i	“	“
Fehmi Abdiu	Anëtar i	“	“
Kujtim Puto	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datën 2.12.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.15 Akti, që i përket:

KËRKUES: Mirjana Bekteshi, në mungesë.

Subjekte të interesuara: Ismet Bashli, në mungesë.

Artan Bashli, përfaqësuar nga av.Artan Hajdari, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr.4859, datë 22.7.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.767, datë 21.6.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.00-2007-1022 (1019), datë 7.9.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, nenet 189, 190, 161, 31, 32 dhe 18 të Kodit të Procedurës Civile.

GJYKATA KUSHTETUESE

VËREN:

Kërkuesja Mirjana Bekteshi ka vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me një kërkesë për shfuqizimin e vendimeve e mësipërme gjyqësore si të papajtueshme me Kushtetutën. Mbledhja e gjyqtarëve vendosi kalimin e kësaj çështjeje për shqyrtim në seancë plenare, datë 28.11.2008. Në këtë seancë kërkuesja nuk u paraqit dhe Gjykata Kushtetuese vendosi të procedonte me njoftimin me shpallje në ambientet e saj dhe shtyrjen e seancën plenare më datë 2.12.2008. Edhe në këtë seancë plenare nuk është paraqitur as kërkuesja, dhe as përfaqësuesi i saj ligjor, si dhe nuk është paraqitur asnjë kërkesë apo njoftim për shtyrje të seancës apo arsyet e mosparaqitjes së tyre.

Ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 1, paragrafi i dytë, parashikon se “Për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj, Gjykata Kushtetuese merr parasysh edhe dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes.” Bazuar në këtë dispozitë, Gjykata Kushtetuese iu referua Kodit të Procedurës Civile, neni 179, i cili parashikon se “Nëse paditësi ose asnjë nga palët, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqiten si në veprimet përgatitore, ashtu dhe seancën gjyqësore dhe rezulton se kanë dijeni rregullisht, gjykata vendos pushimin e gjykimit të çështjes.”

Në kushtet e mësipërme, Gjykata Kushtetuese vlerëson se plotësohen kriteret për pushimin e gjykimit të çështjes në bazë të dispozitës së sipërcituar të Kodit të Procedurës Civile. Konkretisht, pala kërkuese është njoftuar për ditën e gjykimit në këtë Gjykatë, sipas procedurës që parashikon neni 38 pika

3 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Kështu, meqë kërkesja është më vendqëndrim jashtë shtetit, Gjykata Kushtetuese ka proceduar me njoftimin e saj me shpallje në selinë e Gjykatës Kushtetuese. Përveç kësaj, në seancë rezultoi se kërkesja nuk ka njoftuar për ndonjë shkak të arsyeshëm për mosparaqitje.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese konkludon se, përderisa njoftimi me shpallje prezumon dijeninë e kërkuës dhe përderisa kjo e fundit nuk është paraqitur në gjyq, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, në bazë të nenit 179 të Kodit të Procedurës Civile, gjykimi i çështjes duhet të pushohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 1 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, dhe nenin 179 të Kodit të Procedurës Civile, njëzëri,

VENDOSI:

- Pushimin e gjykimit të çështjes.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Fehmi Abdiu, Gjergj Sauli, Vitore Tusha, Xhezair Zaganjori, Petrit Plloçi, Sokol Berberi, Sokol Sadushi, Kujtim Puto

VENDIM